

SHOQERIA PRIVATE PRODHUESH-TREGETARE IMPORT-EKSPORT

" A R I S A - K O N F E K S I O N "

SI PËRVEJËSËSI E KUPIZUAR (SH.P.K.)

Në mbështetje të ligjit nr 7512 dt 10.8.1991 si dhe të ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", në të quajturit kështu dhe Saimir Bidaç, si themelues të shoqërisë private prodhuese-tregëtare për konfeksione import-eksport, sot me dt 14.2.1994, duke përfituar nga aktet ligjore të përmendura më sipër, të cilat i japin të drejtë të plotë juridike për të vepruar kështu:

Formimin e shoqërisë private prodhuese-tregëtare import-eksport me emrin " A R I S A - K O N F E K S I O N " në Tiranë.

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria private prodhuese-tregëtare për konfeksione import-eksport "Arise-Konfeksion" (SH.P.K.) në themelues Binas Bidaç bija e Llambit dhe e Antigont, lindur me 28.3.1965, banues në Tiranë Rr Hoxhe Vokëri Pallati 37 ap 9; dhe Saimir Bidaç biri i Sedikut dhe i Shyqyrisë, lindur me 10.12.1965 dhe banues në Tiranë Rr Hoxhe Vokëri Pallati 37 ap 9. Kjo shoqëri formohet si trashëgimtare e firmës "Arise-Konfeksion" që është shpallur person juridik në vendimin e Gjykatës së Krahut të Tiranës nr 942 dt 22.1.1993 dhe ka ushtruar aktivitetin ekonomik prodhues mbi bazën e licencës së Rajonit 2 me nr 3701764 dt 26.1.1993

QENDRA E SHOQËRISË

Neni 2

Qendra e shoqërisë do të jetë në Tiranë në Rr Myslim Shyri Kulla 4 Kati 2, për me kalimin e kohës mundet të ndërroje vendqendrimin brenda Tiranës si dhe mund të hapë degë të saj në rrethë brenda Shqipërisë.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë është e përfunduar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe në çdo moment.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë private të kësaj shoqërie është si vijon:



Prodhimi dhe tregtimi i konfeksioneve te ndryshme per vete dhe per te tretet, import-eksporti i tyre. Tregtimi i artikujve te ndryshem industriale.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise "Arisa-Konfeksion" do te jete 1.000.000 (njemilion) leke, i cili eshte kontribut i formuesve te kesaj shoqerise Diana Bidaj dhe Saimir Bidaj. Pra pronare te ketij kapitali jane aktualisht ne menyre te barabarte vete formuesit e kesaj shoqerise dhe do te kene pergjegjesi te kufizuar.

Neni 6

Kapitali i kesaj shoqerise mundet te shtohet ose te pakesohet me kalimin e kohes sipas vendimeve qe do te marrin vete pronaret e saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

Shoqeria private "Arisa-Konfeksion" deklarohet e krijuar ne zbatim te plate te normave qe permenden dhe qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo eshte krijuar dhe do te vepruje ne perputhje me ligjen 7512 dt 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarive private dhe privatizimit", te ligjes 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligje te tjera qe do te dalin per kete qellim.

Shoqeria private "Arisa-Konfeksion" vepron si person juridik qe nga koha (dita) e regjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit te Tiranes, ndersa do te ushtroje veprimtarije e saj ekonomike me marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise private nga zyra e tatimeve perkatese.

Neni 8

Shoqeria private ka vulen e saj me permbajtje: Firma private Arisa-Konfeksion Tirana Albania. Permbajtja e vules mund te ndryshoje me pas sipas vendimeve te pronareve te shoqerise.

Neni 9

Shoqeria private "Arisa-Konfeksion" vepron ne regjim te prones private dhe merr persiper vete te drejta dhe detyrime. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj dhe prones.

Firma Private
ARISA
Konfeksione
Shtetshme

- 3 -

Neni 10

Shoqeria private "Arisa-Konfeksion" eshte krijuar dhe eshte pronare e ortakëve Diana Bidaj dhe Saimir Bidaj. Vendimet e marra nga pronaret aktual, si dhe ato vendime te marra ne rast te bashkimit te aktivitetit te kesaj shoqerie me ortakë te tjere, si bashkepronarë ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti, jane te detyrueshme per te gjithë administratorët dhe te punesuarit ne kete shoqeri.

Neni 11

Ortakët e shoqerise "Arisa-Konfeksion", te cilet jane njekohesisht dhe pronaret e shoqerise kane te drejta te barabarta dhe sipas nevojës qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise ekonomike dhe financiare te shoqerise emerojne administratorë ne qender dhe ne dege, nese do te krijohen, si dhe punesojne punetore te aktivitetëve te ndryshme qe zhvillojne, permendur ne nenin 4 te ketij statuti. Emrimi i administratorëve dhe marrja dhe punesimi i punetoreve te ndryshem do te behet duke respektuar ligjin "Mbi marredheniet e punes".

Neni 12

Ortakët e shoqerise dhe me autorizimin e tyre, administratorët e emeruar prej tyre, jane veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj perjashtimi dhe kane mundesite te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Ata kane te drejte midis te tjerash te blejne, te shesin dhe kembejne pasuri, lende te para qe lidhen me veprimtarine e shoqerise, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe dote krijohen ne Republiken e Shqiperise, qofshin ato edhe te huaja, duke siguruar pjesemarrje per qellimin e veprimtarise te permendur ne nenin 4 te ketij statuti si dhe te kryejne çdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave shteterore dhe private, institucioneve bankare dhe financiare, ipotekore dhe çdo lloji tjeter. Ne keto raste administratorët e ngarkuar kane per detyre te njoftojne e ti japin llogari pronarëve te shoqerise.

Neni 13

Pronaret e shoqerise caktojne administratorët te cileve ne aktin e emerimit ju percakton te drejtat, detyrat si dhe pagën. Po keshtu vepron edhe per punetoret e punesuar, me te cilet lidh kontratën e

A handwritten signature in black ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'ARISA KONFEKSION' and 'KONFESION' and has a date field with '10/05/2015' written in it. There are also some illegible handwritten marks within the stamp.

punesimit, ne perputhje me ligjen mbi lidhjen e kontrates individual apo kolektive. Ne kontrate percaktohen te gjitha kushtet e punes si per administratoret edhe per punetoret e punesuar.

Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit, ligjin "Mbi marredheniet e punes", ligjin per "sigurimet shoqerore", ndersa te gjitha te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise dhe ta respektojne me rigorozitet permbajtjen e tij.

Neni 14

Administratoret nuk mund te marrin cilesine e ortakut ne shoqeri dhe as te ushtrojne nje aktivitet konkurues te qdo lloji per llogarit te tyre ose te te treteve, pervec rasteve te autorizuar nga ortaketi aktual te shoqerise. Per qdo shkelje administrative largohet nga puna dhe pergjigjet per demin.

Neni 15

Te gjitha shpenzimet e nevojshme per mbajtjen e administratoreve dhe te te punesuarve perballohen nga vete shoqeria "Arisa-Konfeksion".

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 16

Perfaqesimi i shoqerise do te behet nga ortaket aktuale te saj Diana Bidaj dhe Saimir Bidaj te cilet kane te drejta te barabarta per te perfaqesuar shoqerine ne qdo kohe, per qdo gje dhe ne qdo vend. Perfaqesimi i njerit ortak eshte i detyrueshem edhe per ortakut tjeter dhe anasjelltas. Gjithashtu te drejten e perfaqesimit e kane edhe administratoret e caktuar dhe te autorizuar prej ortakeve ose njerit prej tyre si ne qender edhe ne dge. Me vendim te ortakeve ose njerit prej tyre administratoret edhe mund te zevendesohen. Administratoret zbatojne te gjitha vendimet e ortakeve ne kuadrin e detyruar te caktuara atyre ne aktin e emerimit ose ne proces-verbale te vecar. Ortaket dhe administratoret e shoqerise kane te drejte te perfaqesoj shoqerine "Arisa-Konfeksion" ne organet gjyqesore, ne gjykime si dhe para institucioneve shteterore dhe te caktojne avokate apo te pushojn ata per ceshtje ne gjykim.

SEKRETI I PUNES

Neni 17

Te gjitha te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne



sekretin e punes se shoqerise. Sekret pune paraqesin shkresat, materialet, aktet te cilat me ligj te vegante dhe vendime te nxjerra nga ortaket perbejne sekret pune. Te dhenat informative, bilancet, planet dhe informacioni mbi politiken ekonomike te shoqerise qe u jepen organeve sipas ligjit firmosen nga ortaket. Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga shoqeria.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 18

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise "Arise-Konfeksion" mbylleen me 31 dhjetor te çdo viti, perveç urdherave te veganta qe jep ortaket e shoqerise per kete qellim. Ne fund te periudhes ushtrimore, mujore dhe tremujore, shoqeria ose administratoret nxjerrin bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin ekonomik "Fitime dhe Humbje", bazuar ne ligjet ne fuqi dhe regullat e mbajtjes se kontabilitetit qe kerkohet per personat juridik private dhe shoqerite private nga organet financiare kompetente. Gjithashtu per keto nga ana e ortakeve mund te caktohen specialiste apo revizore nga jashte shoqerise. Bilanci kontabel i shoqerise miratohet dhe nenshkruhet nga ortaket e shoqerise.

Neni 19

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te akumulimit dhe pagese se detyrimeve fiskale i mbeten per perdorimin pronarëve te shoqerise. Eshte e drejta e pronareve qe te vendosin per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto te krijuara si dhe per perdorimin e tyre. Pjesa e fitimit neto qe i perket pronareve mund te transferohet lirisht jasht shtetit shqiptar pa kufizim bazuar ne ligjin 7594 dt 4.8.1992.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

Neni 20

Shperndarja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çdo shkak. Pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise perderisa ti dorezohet personave fizike e juridike te tere likuiduar ne rradhe te pare detyrimet e mundshme ndaj personave te trete.

Arise-Konfeksions
SHOQERIA
TIRANE ALBANIA

Shoqeria "Arisa-Konfeksion" ka numrin e llogarise rrjedhese te regjistruar ne Banken e shtetit ne Tirane.

DISPOZITA TE PERGJITHESIME

Neni 22

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet çdo ligji te veçante perkates te legjisllacionit shqiptar qe eshte ose qe do te d

Neni 23

Ky statut redaktohet ne 4 kopje, nga te cilat nje e merr noteria, nje Gjykata e rrethit, nje Zyra e Tatimeve dhe nje kopje i mbetet shoqerise "Arisa-Konfeksion".

Statuti firmoset nga ortaket ne total dhe faqe per faqe si dhe vules me vulen e shoqerise. Statuti ka 6 faqe.

Tirane me 25.1.1994

Ortaket e shoqerise "Arisa-Konfeksion"

(Diana Bidaj)

(Saimir Bidaj)



Ky statut u perpilua dhe redaktua nga Av. Hysen Braçe

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E DREJTESISE

NOTERIA

Nr. 3301 rep. 552

VERTETIM

Sot me dt. 16.2.94 njemijesenenteqindenenentehjeteekater para meje noteres ARIANA MALLKUÇI ne Tirane u paraqiten personalisht Diana Bidaj, bija e Llambit dhe banuese ne Tirane dhe Saimir Bidaj, biri i Sadikut banues ne Tirane, per identitetin e te cileve me paraqiten leternjoftimet e tyre, me zotesi juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se me vullnetin e tyre te lire kane bere kete statut per te ushtruar veprimtari private me emrin e shoqerise "Arisa-Konfeksion" dhe se jane dakort me permbajtjen etij dhe e nenshkruan ate perpara meje, ndersa une bera vertetimin e tij.

